# Manual Shpjegues i Portalit U-Albania

(Për Sekretaritë)

Ky manual do t'u shërbejë stafit të Universiteteve Publike dhe Private në Republikën e Shqipërsië, gjatë proçesit të regjistrimit të maturantëve në programet e studimit ku ata kanë aplikuar.

1. Për të aksesuar portalin shkoni në : ualbania.arsimi.gov.al




2. Në faqen kryesore, aksesoni hapësirën e regjistrimeve




duke klikuar mbi butonin "Portali i Klasifikimit"



3. Plotësoni fushat me kredencialet tuaja

Paneli i Identifikimit




4. Sistemi dallon 2 profile të ndryshme në varësi të nivelit të aksesit :

   a. Profili i sekretarisë, për personat përgjegjës për regjistrimet
   b. Profili i dekanatit, për stafin përgjegjës të mbikqyrjes së proçesit brenda fakultetit

   Për secilin prej tyre, pamja dhe funksionet e portalit ndryshojnë sipas detyrave që secili profil mbulon gjatë gjithë proçesit të regjistrimeve.

5. Procedura në raste të harrimit të fjalëkalimit.

   Në rast se keni harruar fjalëkalimin, shkoni në tabin **Probleme me fjalëkalimin** si në figuren më poshtë dhe më pas klikoni: *"Klikoni këtu për të ndryshuar fjalëkalimin".*



Në nderfaqjen që do ju hapet, vendosni emailin tuaj me të cilin jeni autorizuar për të aksesuar portalin e regjistrimeve dhe shtypni butonin **Dergo.**




Në këtë moment, në adresen e emailit që vendoset në fushën e Emailit, do të njoftoheni me një link. Klikoni mbi linkun që ju kemi dërguar dhe ndiqni udhezimet për të ndryshuar fjalëkalimin tuaj.

1. Kemi aksesuar portalin si Sekretari, dhe pamja që do shfaqet është si vijon :




2. Blloku i menu-së për sekretarinë do ketë këtë pamje




3. Menuja kryesore për këtë profil është menu “Regjistrime”



4. Duke klikuar mbi mbi Regjistrim i ri, do na shfaqen listat e rankuara nga universiteti, për programet e studimit për të cilat kjo llogari është përgjegjëse për të kryer regjistrime




Zgjedhim programin e studimit për të cilin duhet të kryejmë regjistrimet duke e selektuar nga lista dhe duke klikuar butonin “Shiko Listën”




5. Do të na shfaqet lista e rankuar e aplikantëve për atë program studimi




Rankimi per degen Mjekësi e Përgjithshme

| Nr. | Kodi Maturantit | Emri | Mbiemri | Numri Personal | Piket | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 161114000011 | Vasilika | Gjika | J76128048K | 144052.3 | REGJISTRO |
| 2 | 163220300143 | Bianka | Pajo | J85615026V | 143580.5 | REGJISTRO |
| 3 | 161113500075 | Sara | Myrto | J85702085Q | 142846.666666667 | REGJISTRO |
| 4 | 161113200021 | Inis | Buzi | J95227014B | 142783.2 | REGJISTRO |
| 5 | 161706600060 | Sara | Hyseni | J76126059P | 142637.133333333 | REGJISTRO |
| 6 | 161114000006 | Anxhela | Dafa | J85519014P | 142576.7 | REGJISTRO |
| 7 | 161705200036 | Geraldina | Merkoqi | J85218059A | 142533.3 | REGJISTRO |
| 8 | 161706600090 | Jona | Agastra | J75509056I | 142511.133333333 | REGJISTRO |
| 9 | 161706600118 | Semela | Resuli | J76126056O | 142487.8 | REGJISTRO |
| 10 | 161939400465 | Sara | Todhe | J76030043A | 142212.513333333 | REGJISTRO |
| 11 | 161706400258 | Antoneta | Shahu | J86018064J | 142158.006666667 | REGJISTRO |
| 12 | 161706600120 | Mikela | Kërtusha | J75910086A | 142141.3 | REGJISTRO |

6. Kjo listë mund të shkarkohet nga sistemi nëpërmjet butonit "Shkarko" në dy formate, excel dhe pdf




7. Për të regjistruar maturantin, klikojmë mbi butonin "Regjistro"




8. Do na shfaqet mesazhi për konfirmimin e regjistrimit. Zgjedhim "Regjistro" për të vijuar me regjistrimin, ose "Anullo" për të ndërprerë proçesin




**KUJDES** : *Maturanti i regjistruar tani do të shfaqet me ngjyrë të gjelbër në listën e programit ku është regjistruar, dhe me ngjyrë gri në listat e programeve të tjera ku ka aplikuar, në të cilat, nuk do mund të regjistrohet.*

9. Për të kryer regjistrime të maturantëve të cilëve Universiteti i ka shqyrtuar ankimimin dhe u ka miratuar regjistrimin, apo personave të cilët vijnë nga jashtë shtetit, shkoni tek menuja “Regjistrim i ri për aplikantët nga jashtë dhe të ankimuarit”




10. Për të kryer çregjistrimin e maturantit, klikojmë mbi “Dërgo kërkesë për çregjistrim”, dhe nga lista e maturantëve të regjistruar zgjedhim maturanti të cilin duam të çregjistrojmë.







**Kujdes** : *Në këtë moment maturanti mbetet i regjistruar në programin e studimit. Ai mund të çregjistrohet vetëm pasi kërkesa të jetë miratuar në sistem nga dekanati i fakultetit.*

Për të përfunduar çregjistrimin, klikojmë mbi “Kërkesat e miratuara për çregjistrim” dhe çregjistrojmë ata persona të cilëve u është miratuar kërkesa nga dekanati.




C'regjistro maturantin'
Kodi Maturantit:
Emri:
Mbiemri:
Numri personal:
JENI I SIGURT QE DONI TE KRYENI C'REGJISTRIMIN E KETIJ MATURANTI?
Cregjistro maturantin
Anullo